



GJYKATA E SHKALLËS SË
PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË



FTESË

10 - MAJ

“DITA E DREJTËSISË”

“Të informohemi, të kuptojmë, të besojmë tek Drejtësia”

Takim i hapur me publikun, nxënës, studentë, qytetarë, aktorë
dhe përdorues të sistemit të drejtësisë.

*Në datën 10 Maj 2023, ora 09:00 – 10:00, pranë Dhomës Penale, Rruga Jordan Misja - Tiranë,
dhe 11:00 – 12:00, pranë Dhomës Civile Blv: “Gjergj Fishta”, Tiranë.*

Dita Kombëtare e Drejtësisë

Më 10 maj 1913, qeveria e Ismail Qemalit dekretoi “*Kanunin e zhurisë*”, si aktin e parë juridik për organizimin dhe funksionimin e sistemit juridik në shtetin e pavarur shqiptar.

Në këtë kanun, ashtu si dhe në disa akte të tjera qeveria vendosi rregullat e para të shtetit shqiptar, për organizimin e sistemit gjyqësor, prandaj kjo datë përkujtohet si Dita Kombëtare e Drejtësisë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ushtron veprimtarinë gjyqësore me seli në qytetin e Tiranës.

Ajo përfshinë në kompetencën e saj tokësore Bashkinë Tiranë, Kamëz, Vorë dhe Krujë.

Kompetenca lëndore e kësaj gjykate, lidhet me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në fushën juridiko civile, tregtare, familjare, penale.


Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është e organizuar në dy dhoma, si dhe në dy godina të ndryshme. Në dhomën civile, e cila ndodhet pranë Bulevardit “Gjergj Fishta”, si dhe dhoma penale që ndodhet në rrugën “Jordan Misja”.

Dhoma civile është e organizuar në seksionet e ndara sipas fushave përkatëse të gjykimeve: tregtare, civile, familjare.

Dhoma penale ka të përfshirë brenda saj, edhe seksionin e posaçëm për të Miturit, të cilët mund të gjykohen nga një trupë gjyqtarësh të trajnuar dhe të caktuar posaçërisht për çështjet gjyqësore në të cilat subjektet (*personat në konflikt me ligjin apo vikimat e veprave penale*) janë në moshë të mitur, nën 18 vjeç, ose në momentin e gjykimit të tyre ata rezultojnë 18 – 21 vjeç dhe konsiderohen “*i riu*”.

Numri i organikës së gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 45 gjyqtarë.

Aktualisht në detyrë rezultojnë 24 gjyqtarë që gjykojnë efektivisht pranë dhomës civile, dhe 21 gjyqtarë pranë dhomës penale.



Kontaktet me Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë

Dhoma Civile: Blv. "Gjergj Fishta", e-mail: infocivile@gjykatatirana.gov.al

Dhoma Penale: Rr. "Jordan Misja", e-mail: infopenale@gjykatatirana.gov.al

WEB: <https://www.gjykatatirana.gov.al> ***Facebook:*** <https://www.facebook.com/gjshpjpt>

Koordinatori për të drejtën e informimit

E-mail: osmaili@gjykatatirana.gov.al

Tel/Cel: +355695335955



“Të gjitha gjërat e mëdha janë të thjeshta, dhe shumë prej tyre mund të shprehen me një fjalë të vetme, liri, drejtësi, nder, detyrë, mëshirë, shpresë.” - Uinston Çërcill.

“Shpresa e një bote të sigurtë dhe të jetueshme varet nga jokonformistë të disiplinuar të cilët i kushtohen drejtësisë, paqes dhe vëllezërisë.” - Martin Luter King, Jr.

“Të gjitha gjërat e mëdha janë të thjeshta, dhe shumë prej tyre mund të shprehen me një fjalë të vetme, liri, drejtësi, nder, detyrë, mëshirë, shpresë.” - Uinston Çërcill.

“Zoti ynë që je në qiell, jepna fuqine ta mbajme gojën të mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë! Falna durimin ta thellojmë një punë përpara se të shkruajmë përmbi të, frymëziona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthimet e shtypit.” - Faik Konica

“Forca nuk përbën drejtësi ... bindja është e drejtë vetëm ndaj fuqive të ligjshme.” - Zhan-Zhak Ruso

“Është mrekulli të jesh i ndershëm, por është gjithashtu shumë me rëndësi të veprosh drejt.” - Uinston Çërcill

“Drejtësi do të thotë të mos i lëndosh njerëzit; mirësjellje do të thotë të mos i fyesh ata.” - Ciceroni